



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2204/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI128/22

Parashtrues

Shqiprim Xheladini

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjyqimit [Pml. nr. 141/2022] të 11 majit 2022 të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shqiprim Xheladini, me vendbanim në fshatin Sllubicë, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokatja Shemsije Asllani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 141/2022] të 11 majit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [APS. nr. 10/2021] e 11 marsit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 213/2019] e 24 shtatorit 2021 të Gjykatës Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentacion shtesë në Gjykatë.
7. Më 26 gusht 2022, Gjykata, për regjistrimin e kërkesës, njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe të njëjtën datë një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 5 shtator 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI128/22 caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI128/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 23 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

- a. *Procedura hetimore dhe ngritja e aktakuzës*

11. Më 19 nëntor 2019, Njësia hetimore rajonale e policisë së Gjilanit ngriti kallëzim penal ndaj parashtruesit të kërkesës, vëllait të tij Shp. Xh. dhe L. Q. Të njëjtën datë, parashtruesi i kërkesës ishte marrë në pyetje nga njësia hetimore e policisë.
12. Më 20 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Prokurori Themelore), nisi hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij Shp. Xheladini, nën dyshimin se në lagjen dardania të Gjilanit të njëjtit tentuan të privonin nga jeta L. Q. Ky i fundit gjithashtu dyshohej se kishte tentuar të privonte nga jeta parashtruesin e kërkesës dhe vëllain e tij. Meqë në këtë rast penal përfshihen edhe persona të tjerë, Gjykata do të fokusohet në pjesët relevante të parashtrësive që ndërlidhen vetëm me parashtruesin e kësaj kërkesë.
13. Më 20 nëntor 2019, Gjykata Themelore ia caktoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit, e cila i është vazhduar më pas, deri më 10 prill 2020.
14. Më 5 dhjetor 2019, Prokuroria Themelore, ngriti aktakuzën [PP. I. nr217/2019], ndaj parashtruesit të kërkesës nën dyshimin se kishte kryer veprat penale: (i) vrasje në tentativë, në bashkëveprim dhe bashkëkryerje, nga neni 172, lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) dhe (ii) mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së.
15. Parashtruesi i kërkesës, kundër aktakuzës së Prokurorisë Themelore, parashtrroi kërkesë në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës kërkoi hedhjen në tërësi si të pabazuar të aktakuzës, kërkesë e cila më 20 janar 2020 u refuzua si e pabazuar nga Gjykata Themelore.

b. Gjykimi i rastit penal

16. Më 24 shtator 2021, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [PKR. nr. 213/2019], pasi rikualifikoi veprën penale, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprave penale: për të cilën e dënoi me burgim efektiv në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, dhe (ii) mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së, për të cilën e dënoi po ashtu me burgim efektiv në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Parashtruesit të kërkesës me këtë rast iu shqiptua dënimi unik me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej dy (2) vite, e tre (3) muaj, duke ia llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga 18 nëntori 2019, deri më 10 prill 2020.
17. Më 5 janar 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal.
18. Më 11 mars 2022, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [APS. nr. 10/2021], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke arsyetuar se gjykata e shkallës e parë ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare për kryerjen e veprave penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtorë. Tutje theksohet se në Aktgjykimin e atakuar janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat lidhur me veprimet inkriminuese që përbëjnë veprën penale të rikualifikuar nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ekziston asnjë kundërtënie në mes të dispozitivit të aktgjykimit dhe arsyeve të paraqitura në arsyetimin e asaj gjykate.

c. *Mjeti i jashtëzakonshëm (KML)*

19. Më 30 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet mbrojtësit të tij parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, me pretendimin për shkelje të ligjit penal dhe procedural.
20. Më 8 prill 2022, Kryeprokurori i Shtetit i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
21. Më 11 maj 2022, Gjykata Supreme me Aktgjykimin [Pml. nr. 144/2022], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe la në fuqi aktgjykimet e instancave më të ulëta. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme u deklarua se i mbështet në tërësi gjetjet e gjykatave të instancës më të ulët, si për nga cilësimi i veprës penale po ashtu edhe sanksioni penal i shqiptuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre shkelën të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenet: 24.1 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 të KEDNJ-së.

i. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe as instancat me të ulëta nuk kanë arritur të arsyetojnë në aktgjykimet e tyre, pretendimin e vazhdueshëm se përse që të tre të dënuarit Shqiprim Xheladini, Sh. Xh. dhe L. Q., janë dënuar me dënim të njëjtë në kohëzgjatje prej dy (2) vite, e tre (3) muaj me burgim efektiv, duke mos gjetur fajtorin kryesor që e ka shkakuar ngjarjen për të cilën është dënuar dhe ai. Përkitazi me të drejtën për “vendim të arsyetuar” parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve të Gjykatës KI72/12, KI135/14 dhe KI97/16, KI87/18 dhe KI230/19 dhe disa rasteve të GJEDNJ-së, ku përmenden parimet dhe detyrimet e gjykatave për arsyetimin e vendimeve të tyre.
24. Parashtruesi i kërkesës në këtë vazhdë pretendon: *“Me këtë rast e ritheksojmë se Gjykata Supreme, me aktgjykimet e nxjerra nuk ka arritur të bëjë dallimin e personave që kanë qenë fajtorë dhe të gjithë i ka barazuar, pa i shqyrtuar fare rrethanat e rastit për secilin veç e veç, përfshirë parashtruesit e kërkesës. Kjo në fakt, siç u theksua edhe më sipër i bën aktet e kontestuara të paarsyetuara dhe rrjedhimisht mosarsyetimin e bën vendosjen arbitrare, çka rezulton me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. [...]. Në dritën e rrethanave të rastit konkret, Gjykata Supreme e as gjykatat e tjera, nuk kanë arritur të dallojnë dhe të argumentojnë e arsyetojnë, se cili nga të dënuarit ka qenë fajtor, dhe në këtë mënyrë i ka barazuar të gjithë të dënuarit, përfshirë edhe parashtruesit e kërkesës, pa dhënë një arsyetim të qëndrueshëm dhe bindës se përse ka ndodhur kjo”.*

ii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 54 të Kushtetutës

25. Përveç pretendimit për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe instancat më të ulëta shkelën po ashtu të drejtën e tij të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, sepse dështuan të garantojnë gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Tutje, parashtruesi i kërkesës, thekson se: *“Mungesa e vendimit (aktgjykimit) të argumentuar, në fakt ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të*

KEDNJ-së (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe nenin 54 të Kushtetutës, që ka të bëjë me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, për parashtruesit e kërkesës. Parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera theksojnë edhe njëherë që Gjykata Kushtetuese, me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tyre, por edhe parimit të sigurisë juridike dhe ndalimit të arbitraritetit të gjykatave, gjatë shqyrtimit të rastit, të marr parasysht në mënyrë të hollësishme praktikën e GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës”.

iii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 24.1 të Kushtetutës

26. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta, duke mos arritur që të argumentojnë dënimin, në raport me rrethanat konkrete të rastit, si dhe duke i dënuar njëjtë, që të tre dhe pa bërë dallimin subjektiv dhe individualizimin e dënimit, i kanë shkelur atij barazinë para ligjit, respektivisht e kanë diskriminuar, nga shkak se e kanë trajtuar në mënyrë të njëjtë, në rrethana të ndryshme dhe jo në pajtim me ligjin penal dhe qëllimin e dënimit. Sipas tij, Gjykata duhet të merr parasysht qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në ligj dhe rrethanat lehtësuese dhe renduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin.
27. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson, “...Gjykata Supreme, e Apelit dhe ajo Themelore, nuk kanë arritur të trajtojnë rrethanat renduese dhe lehtësuese të të tre të dënuarve dhe kanë dështuar të arsyetojnë aktgjykimet e tyre, duke ardhur në një situatë që në mënyrë arbitrare i kanë dënuar të tre të pandehurit, në mënyrë të njëjtë edhe pse rrethanat lehtësuese dhe renduese për ta kanë qenë krejtësisht të ndryshme. Këtu sidomos nuk është marrë parasysht fakti që i dënuari L. Q., ka qenë i pari i cili ka shkaktuar ngjarjen, nga e cila kanë rrjedhur veprat penale. Këtë fakt, gjykatat e rregullta e kanë riaktivizuar në tërësi dhe rrjedhimisht kanë nxjerrë një drejtësi të mohuar për parashtruesit e kërkesës, duke i vendosur ata në një pozicion të barabartë me fajtorin kryesor dhe shkaktarin e rastit, të dënuarin L. Q. Parashtruesit e kërkesës e kanë të qartë që Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit, por këtë elaborimi e bëjnë për të shpërfaqur mungesën e arsytimit të vendimit nga ana e gjykatave të rregullta, respektivisht ajo Themelore, e Apelit dhe Supreme”.
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pranueshme kërkesën në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës; duke marrë parasysht elaborimin e fakteve të lartcekura, të vërtetojë dhe konstatojë shkeljen dhe cenimin e të drejtave, sipas pretendimeve më lart, të parapara me nenet 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe neni 6.1 të KEDNJ-së, të shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml, nr.141/2022 të 11 majit 2022 dhe të kthejë atë në rishqyrtim në pajtim me vendimin e saj.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

[...]

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019)

Neni 356

Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm

1. Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit apo ndonjë mjeti tjetër vdekjeprurës, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara me ligj nuk i vendos pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, vërshimi, eksplozimi, helmimi ose për mbrojtjen nga gazrat helmuese, rrezatimi jonizues, forcat mekanike, energjia elektrike ose nga ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, apo këto pajisje nuk i mirëmban në gjendje të rregullt apo nuk i vë në përdorim ose në përgjithësi nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve ose ku përdoret një eksploziv ose mjet tjetër vdekjeprurës në, brenda ose kundër një vendi për përdorim publik, një ndërtesë shtetërore

ose qeveritare, një sistemi të transportit publik ose një infrastrukture ose me qëllim të shkakimit të vdekjes ose lëndimit të rëndë trupor ose me qëllim që të shkaktojë shkatërrim të gjerë të një vendi, objekti ose sistemi të tillë, kur një shkatërrim i tillë rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike ose të detyrojë një qeveri ose një organizatë ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer një vepër, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni kryhet në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.

8. Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.

9. Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 366

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve

1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

3. Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Neni 367

Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm

1. Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

3. Arma apo mjete i rrezikshëm i përdorur në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Nenit 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]

31. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

32. Rreth përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 141/2022] e 11 majit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
33. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nënregullin 2 të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 39
(Kriteret e papranueshmërisë)

2 Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

34. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituaniës*, nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, kategoria (iii)).
35. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, një ankesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih, rastin e GjEDNj-së: *Talpis kundër Italisë*, nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
36. Gjykata, duke iu rikthyer shqyrtimit të kërkesës rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të neneve 24.1, 31 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNj-së.
37. Gjykata, referuar shkresave të lëndës vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ka të bëjë me shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të drejtë, e cila ndërlihet me mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave të rregullta.
38. Andaj, pretendimin kryesor dhe thelbësor të parashtruesit të kërkesës Gjykata do e shqyrtojë dhe analizojë nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6.1 të KEDNj-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara nga GjEDNj-së, në bazë të së cilave kjo Gjykatë dhe gjykatat e rregullta në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës janë të obliguara që: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

I. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës për “vendim të arsyetuar”

a) Parimet e përgjithshme

39. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet Hadjianastassiou kundër Greqisë, nr. 12945/87 Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; Van de Hurk kundër Holandës, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; Hiro Balani kundër Spanjës, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; Higgins dhe të tjerët kundër Francës, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; Hirvisaari kundër Finlandës, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; Suominen kundër Finlandës, nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; Pronina kundër Ukrainës, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe Tatishvili kundër Ruisë, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues Naser Husaj, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues Muharrem Blaku dhe të tjerët, Aktvendim i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës IF Skadiforsikring, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues Bedri Salihu, Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, parashtrues Bayerische Versicherungsverband, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135; dhe së fundmi KI195/20, parashtrues Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 120).
40. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GjEDNj-së, H. kundër Belgjikës, nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, të cituar më lart, paragrafi 139; dhe rastin KI87/18, parashtrues IF Skadiforsikring, paragrafi 44).
41. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që duhet të adresohen, dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GjEDNj-së Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; Hiro Balani kundër Spanjës, nr. 18064/91 Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe Higgins dhe të tjerët kundër Francës, nr. 134/1996/753/952. Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues IKK Classic, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18, parashtrues IF Skadeforsikring, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin e GjEDNj-së Morerira Ferreira kundër

Portugalisë, nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përmendura aty; shih edhe rastet e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137; dhe së fundmi KI195/20, parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 122).

42. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; KI87/18, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138; dhe së fundmi rastin KI195/20, parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 123).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

43. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me mungesën e arsyetimit të aktgjyqimeve të gjykatave të rregullta, përkitazi me shqiptimin e lartësisë së dënimit njësoj për të gjithë të akuzuarit, duke theksuar se të njëjtat nuk morën parasysh veç e veç rrethanat lehtësuese dhe renduese të secilit prej tyre.
44. Gjykata, në lidhje me këtë pretendim i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [PS. nr. 14/2022] të 11 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi: “Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata për secilin të akuzuar veç e veç, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e të akuzuarve pas kryerjes se veprës penale ku të njëjtit kanë rregulluar raportet mes tyre, e po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese mori edhe sjelljen e të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa si rrethanë renduese gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale, duke pasur parasysh se veprimet e ndërmarra nga të akuzuarit të cilat veprime janë të një përgjegjësie penale më të lartë e në veçanti rrethanat nën të cilat janë kryer këto vepra penale pasi që kemi të bëjmë me vepra penale me të cilat rrezikohet jeta e qytetarit dhe në momentin se kur kanë ndodhur të shtënat me armë ka pasur qytetarë tjerë afër vendit të ngjarjes”.
45. Gjykata Themelore, sa i përket shqiptimit të dënimit në harmoni me veprën penale, duke marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarve tjerë, arsyetoi: “Gjykata, duke u nisur nga të gjitha këto, të akuzuarve Shp. XH., Shqiprim Xheladini dhe L. Q., i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit”.

46. Gjykata tutje i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [PAKR. nr. 49/2020] të 3 marsit 2022 të Gjykatës së Apelit, e cila, arsyetoi: "... se pretendimet ankimore të mbrojtësve, ... se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, janë të pabazuara për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe nga gjendja faktike e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, rezulton se gjykata e shkallës së parë të ketë zbatuar drejtë edhe ligjin penal, kjo për faktin se nga provat e administruara dhe të vlerësuara ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve përmbushen elementet e veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm".
47. Ndërsa sa i përket vendimit mbi matjen e dënimit në harmoni me veprën penale të kryer, Gjykata e Apelit, duke iu referuar aktgjykimit të shkallës së parë përkitazi me rrethanat lehtësuese dhe renduese, arsyetoi: "... se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është i përshtatshëm dhe proporcional, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit se si është kryer vepra penale, si dhe rrethanat lehtësuese dhe renduese për të akuzuarit siç u cekën më lart. Andaj, Gjykata e Apelit duke vlerësuar rrethanat e lartpërmendura në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, gjen se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, e të akuzuarve dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dënimi i tillë do t'i shërbej preventivës individuale që të akuzuarit në të ardhmen të mos përsërisin vepra penale të këtilla apo tjera, si dhe preventivës së përgjithshme që dënimi i këtillë të ndikojë edhe te tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, me çka do të arrihet edhe qëllimi i dënimit siç parashihet me nenin 38 të KPRK-së".
48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dhe Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, e cila përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, "se gjykatat e instancës me të ulët, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar ligjin penal, gjegjëshit nenin 385, sepse nuk morën parasysh rrethanat që e përjashtonin përgjegjësinë penale të tij, duke e shpallur fajtor në mënyrë të barabartë si shkaktuesin e problemit po ashtu edhe atë si i akuzuar që kishte vepruar në mbartje të nevojshme, theksoi si në vijim: "*Sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimet e atakuara nuk janë të përfshira as me shkelje të ligjit penal nga neni 385 të KPPK-së, për faktin se veprat penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor janë vepra penale të sanksionuara me nenet 356, par.1 të KPRK-së, dhe 366, par. 1 të KPRK-së, ndërsa në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë e të njëjtit. Kështu kjo gjykatë edhe pse mbrojtësi pretendon se në veprimet e të dënuarit formohen elementet e veprës penale, përdorim i armëve apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367, par. 2 të KPRK-së, e të kryera në mbrojtje të nevojshme dhe ku thotë se vepra penale me të cilën i dënuari akuzohet nuk përbën vepër penale, nuk qëndrojnë për faktin se gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë janë mbështetur në gjendjen e fakteve të vërtetuara, të dëshmitarëve, të cilët edhe kjo gjykatë i pranon si të drejta, kur kanë përfunduar se në veprimet e të dënuarit janë realizuar të gjitha elementet e veprës penale në bashkryerje të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 356, par.1, lidhur me nenin 31 të Kodit penal të Republikës së Kosovës".*
49. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Gjykata vlerëson se e njëjta në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar adresoi të gjitha aspektet e rastit. Fillimisht ajo arsyetoi konkluzionet përkitazi me provat vendimtare, bazueshmërinë dhe besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve, vërtetësinë e provave materiale dhe aspektet ligjore të veprës penale, pastaj mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese sa i përket shqiptimit të dënimit me burgim efektiv në harmoni me veprën penale, çështje të cilat sipas vlerësimit të Gjykatës bien plotësisht në juridiksionin e saj, si gjykatë e faktit.

50. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës po ashtu ka pasur mundësi që pretendimet kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, t'i ngriste në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet parashtrimit të ankesës, ku vërehet se kjo e fundit adresoi të gjitha pretendimet e ngritura, si për sa i përket fakteve vendimtare, po ashtu edhe për sa i përket pretendimeve për shkelje të ligjit penal dhe procedural. Për më tepër, Gjykata e Apelit kishte vlerësuar edhe pretendimet përkitazi me shqiptimin e dënimit duke arsyetuar se masa e dënimit të shqiptuar është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, e të akuzuarve.
51. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nëpërmjet ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme kishte pretenduar shkelje të ligjit penal dhe procedural, dhe kjo e fundit u është përgjigjur në mënyrë konkrete pretendimeve të tij, duke arsyetuar se përse nuk janë të bazuara pretendimet e tij. Gjetjet e gjykatave më të ulëta Gjykata Supreme i konsideroi të drejta dhe të mbështetura në fakte të vërtetuara, në dëshmitë e dëshmitareve, dhe nga shikimi i provova nga vendi i ngjarjes. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj arsyetoi se përse nuk bëhej fjalë për mbrojtje të nevojshme në kuptim të nenit 367.2 të KPRK-së, por për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm në bashkryerje nga neni 356.1 i KPRK-së, duke i dhënë kështu përgjigje pretendimit të tij se gjykatat e instancave më të ulëta e shpallën njësoj fajtorë si L. Q-në, po ashtu edhe atë.
52. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme të GjEDNj-së, siç janë elaboruar më lart dhe bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje të plotë me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës është e qartë se vendimmarrja ishte e bazuar në prova të ndryshme, në dëshmitë e dëshmitareve, por edhe në prova të tjera materiale, siç në mënyrë të detajuar janë listuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të cilat si të tilla i ka konfirmuar Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.
53. Andaj, bazuar si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të mbështes dhe arsyetoj pretendimin e tij se vendimeve të gjykatave të rregullta u mungon arsyetimi i duhur, dhe kështu është shkelur e drejta e tij për një vendim të arsyetuar e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë, nr. 5503/02, Aktgjykim, i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
54. Gjykata e konsideron të rëndësishme të përsëris qëndrimin e përgjithshëm se "drejtësia" e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së nuk është drejtësi *substanciale*, por drejtësi *procedurale*. Në rrafshin praktik, koncepti i drejtësisë procedurale nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës KI22/19,

me parashtrues: *Sabit Ilazi*, Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 dhe rastet e cituara aty, po ashtu rastin [KI98/21](#), cituar më sipër paragrafin 59).

55. Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura, sepse si parashtruesi i kërkesës po ashtu dhe mbrojtësi i tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat e rregullta, se ata kanë pasur mundësi që përgjatë gjithë procedurës t'i kundërshtonin provat fajësuese. Megjithatë duket se parashtruesi i kërkesës nuk është pajtuar me vendimin e gjykatave për sa i përket cilësimit të veprës penale dhe me lartësisë së dënimit të shqiptuar. Gjykata edhe me tej thekson se është në diskrecionin e plotë të gjykatave të rregullta të bëjnë cilësimin e veprës penale dhe të shqiptojnë masën e duhur të sanksionit penal në raport me faktet e vërtetuara dhe provat e administruara.
56. Për më tepër, shikuar në tërësinë e saj procedura e zhvilluar pranë instancave gjyqësore në dritën e rrethanave të rastit konkret nuk ishte e padrejtë ose arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, GjEDNj, rastin, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI128/18](#), parashtrues; *Limak Kosovo International Airport SH.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendimi i 27 majit 2019, paragrafi 58, [KI22/19](#), parashtrues: *Sabit Ilazi*, Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42, dhe [KI98/21](#), cituar më lart, paragrafi 69).
57. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkatësisht me shkeljen e të drejtës për një “vendim të arsyetuar”, i takojnë kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, sepse kërkesa në këtë pjesë, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar.

II. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet e tjera

58. Në vlerësimin e pretendimeve tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimit kryesor për shkelje të së drejtës për “*vendim të arsyetuar*” nga gjykatat e rregullta, pretendon dhe në shkelje të neneve 24.1 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të KEDNj-së. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe e neneve të instrumenteve a konventave që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të atyre neneve, në qoftë se më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe KEDNj-së si dhe të instrumenteve tjera ndërkombëtare, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
59. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, në baza kushtetuese duhet deklaruar qartazi të pabazuara.

Përfundim

60. Si përmbledhje e të gjitha shtjellimeve dhe analizave të mësipërme, Gjykata konkludon se: (I) pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar, i takojnë kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve të *"pambështetura apo të paarsyetuara"* andaj për këtë arsye të njëjtat shpallen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesave për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 24.1 dhe 54 të Kushtetutës, dhe me nenin 13 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve të *"pambështetura ose të paarsyetuara"*, andaj për këtë arsye të njëjtat po ashtu shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese.
61. Rrjedhimisht, kërkesat e parashtruesit të kërkesës, në tërësinë e saj, duhet deklaruar e papranueshme, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

